



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


7 QERSHOR 2022

** Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e harmonizimit të Komisionit Evropian. Prej muajit qershor 2021, publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtimet bëhet me frekuencë mujore.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) regjistroi një kthesë në rritje në muajin maj, për herë të parë për vitin 2022 (Grafik 1). Rritja e tij me 4.6 pikë përqindje u përcaktua nga përmirësimi i besimit në pothuaj të gjithë sektorët e ekonomisë, me kontribute më të theksuara nga sektori i shërbimeve dhe i tregtisë (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) u rrit me 4.3 pikë përqindje në maj. Kjo rritje reflektoi kryesisht vlerësime më optimiste të bizneseve për *prodhimin industrial*. Vlerësimet e tyre për *kërkesën e brendshme* dhe *kërkesën nga eksportet* u përmirësuan gjithashtu këtë muaj. Edhe pritjet e bizneseve të industrisë për *prodhimin* dhe *punësimin në të ardhmen* janë rritur (Tabelë 2, sektori i industrisë). Pritjet për *çmimet e prodhimit*, të cilat kanë regjistruar prirje rritëse të fortë gjatë muajve të fundit, regjistruan rënie në muajin maj.

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) regjistroi rënie të lehtë me 0.6 pikë përqindje në muajin maj (Grafik 2). Rënia u shkaktua nga vlerësime më pesimiste për *aktivitetin ndërtues*. Nga ana tjetër, vlerësimi i tyre për *kontratat porositëse* si dhe pritjet për nivelin e punësimit ishin në rritje. Pritjet për *çmimet* në të ardhmen u ulën në muajin maj, për të dytin muaj rresht (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.
Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) shënoi rritje me 7.2 pikë përqindje në muajin maj, krahasuar me muajin e kaluar. Rritja e tij u përcaktua nga vlerësimet më optimiste të bizneseve, si për *ecurinë e aktivitetit të tyre*, ashtu edhe për *kërkesën*. Pritjet e bizneseve të shërbimeve për nivelin e *punësimit* dhe të *çmimeve* të tyre në të ardhmen janë në rritje këtë muaj (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) shënoi rritje me 6.8 pikë përqindje në muajin maj, i ndikuar nga vlerësimet optimiste të bizneseve të tregtisë për *ecurinë aktuale të biznesit të tyre*, si dhe pritjet optimiste për *punësimin* në muajt e ardhshëm (Tabelë 2, sektori i tregtisë). Pritjet e tyre për *kërkesën* dhe *ecurinë e biznesit* në muajt e ardhshëm janë vlerësuar gjithashtu në rritje. Pritjet për *çmimet* që do të vendosin në të ardhmen janë vlerësuar me rënie edhe këtë muaj në këtë sektor.


Treguesi i besimit konsumator (TBK) shënoi rritje të lehtë me 2 pikë përqindje në muajin maj (Grafik 2). Kjo rritje reflektoi përmirësimin e të gjithë komponentëve përbërës të TBK-së: vlerësimin lidhur me *blerjet në shuma të mëdha*, *pritjet për situatën e tyre financiare* dhe për *situatën e përgjithshme ekonomike* në vend (Tabelë 2, konsumatorët).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve *

	Vlerat			2022					Situata aktuale	
	min	mes	max	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Koniunkturale **	Strukturore ***
Industri	-59.8	-12.3	6.1	-9.0	-7.7	-4.8	-5.7	-1.4	↑	+
Ndërtim	-57.2	-28.2	-8.4	-16.4	-19.6	-19.1	-16.7	-17.3	↓	++
Shërbime	-45.3	5.0	26.7	22.2	20.5	21.9	19.5	26.7	↑	++
Tregti	-31.9	-2.5	18.7	11.5	6.4	5.0	2.4	9.2	↑	++
Konsumator	-40.0	-25.3	-16.3	-30.8	-31.1	-37.9	-36.1	-34.1	↑	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

***) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

****) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2021				2022				
	Shtat	Tetor	Nëntor	Dhjet.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	17.1	22.7	15.5	19.5	18.6	18.5	19.2	20.1	29.5
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-16.5	-11.3	-17.2	-14.6	-15.7	-20.5	-14.3	-18.6	-15.4
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-20.7	-17.1	-17.6	-21.3	-29.9	-21.2	-19.2	-18.5	-18.3
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-5.1	-6.2	-6.8	-4.2	-1.7	-0.1	-5.5	-6.9	-5.1
Prodhimi pritje (pyetja 5)	35.6	33.5	36.2	31.9	33.3	29.9	23.8	27.4	29.6
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	21.3	36.0	37.3	38.0	42.1	39.1	71.4	68.2	50.5
Punësimi pritje (pyetja 7)	10.9	9.9	12.3	18.4	20.6	15.9	8.8	14.8	18.2
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	4.3	4.2	6.2	-1.6	1.6	-2.3	0.6	0.8	-1.6
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-38.4	-34.0	-23.0	-37.3	-34.4	-37.0	-38.8	-34.1	-33.0
Punësimi pritje (pyetja 4)	10.7	7.6	9.6	5.9	15.8	2.4	2.4	-1.0	4.1
Çmimet pritje (pyetja 5)	18.4	22.3	29.6	23.8	17.9	30.9	49.7	46.1	33.3
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	15.4	22.0	18.3	23.9	19.7	20.0	21.2	21.4	26.0
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	18.3	21.5	24.4	27.7	24.7	20.9	22.5	17.5	27.4
Kërkesa pritje (pyetja 3)	23.0	12.7	30.5	35.7	31.3	28.2	25.5	27.2	37.0
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	4.9	8.3	11.1	17.6	-6.5	13.3	6.6	14.0	10.5
Punësimi pritje (pyetja 5)	9.2	0.5	12.5	6.7	13.4	17.9	13.1	12.0	13.9
Çmimet pritje (pyetja 6)	8.3	30.0	22.7	22.8	24.6	31.5	49.4	40.5	46.3
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	11.9	9.7	9.5	9.6	20.3	9.6	6.9	6.6	14.6
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	-0.1	0.7	0.3	-0.3	-1.2	-1.2	-1.0	3.1	5.4
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	19.9	24.6	26.2	34.7	29.1	23.5	13.9	3.3	10.2
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	24.9	31.3	28.8	35.9	28.2	25.8	14.0	10.5	13.6
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	1.3	1.9	1.0	5.5	2.8	3.1	3.1	-1.8	3.7
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	11.6	27.4	44.4	36.6	28.1	42.1	60.3	51.4	45.9
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-7.0	-13.6	-14.7	-12.6	-12.8	-13.3	-15.5	-17.2	-17.6
Situata financiare, pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	8.0	-4.2	-3.0	-1.3	-1.5	-2.1	-11.9	-7.9	-6.7
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-18.8	-22.6	-26.4	-23.6	-23.4	-22.7	-26.3	-31.2	-31.4
Situata ekonomike, pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	1.1	-11.2	-6.5	-5.5	-4.0	-3.5	-18.3	-16.5	-10.1
Çmimet aktuale (pyetja 5)	0.1	26.9	30.8	28.6	25.9	24.5	39.2	53.4	50.7
Çmimet, pritje (pyetja 6)	-8.1	7.8	-1.6	-3.6	-7.6	-7.8	17.7	5.8	4.0
Papunësia, pritje (pyetja 7)	7.0	12.7	11.1	12.1	9.6	9.5	12.8	11.9	10.7
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-62.9	-64.9	-66.5	-64.7	-69.3	-69.0	-71.4	-69.7	-69.4
Blerjet e mëdha, pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-48.1	-50.8	-52.9	-48.8	-48.5	-50.0	-50.0	-50.6	-50.4
Kursimi aktual (pyetja 10)	-44.7	-49.8	-52.7	-47.4	-41.9	-45.5	-47.9	-47.4	-46.8
Kursimi, pritje (pyetja 11)	-43.0	-48.9	-48.8	-45.9	-44.7	-45.2	-50.5	-47.9	-45.9
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	3.6	-1.4	0.2	-0.3	1.1	0.5	-1.1	-0.2	0.0

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.